

URDHËR
Nr. 3778, datë 8.10.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa “a”, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor-ASIG, jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor- ASIG.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor-ASIG të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor- ASIG, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRII SHTETIT PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE
Milena Harito